



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**

Nr. 7811, prot

Tiranë, më 30/09 2025

URDHËR

Nr. 338, datë 30.09 2025

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.722, DATË 11.11.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE E
DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E AFTËSISË SË
KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL DHE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE E
TË DETYRAVE TË TYRE, TË NDRYSHUAR**

Bazuar në ligjin nr.57, datë 18.07.2019, “Për Asistencën Sociale në RSH”, pikat 4 dhe 16 të kreut IV, të VKM nr.722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e masës, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, gërmat a, b, c dhe ç, të pikës 2 të kreut IV të VKM nr.431, datë 08.06.2016, “Për përcaktimin masës, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot, VKM nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar, VKM nr. 540 datë 29.09.2025 “Për indeksimin e Pensioneve”:

URDHËROJ:

1. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2, të kreut IV, të VKM nr.722, datë 11.11.2019, është 14,930 (katërmëdhjetëmijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë në muaj.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma “a”, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016, të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 8,958 (tetëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
3. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma “b”, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016, të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 11,944 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
4. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma “c”, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016, të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 14,930 ((katërmëdhjetëmijë e nëntëqind e tridhjetë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**

5. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2 gërma “ç”, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për të rritur dhe fëmijë, është 17,916 (shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
6. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 16, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për shërbimet gjithëpërfshirëse të ndihmësit personal, është 17,916 (shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.
7. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 17, të kreut IV, të VKM nr.431, datë 08.06.2016 , të ndryshuar, për shërbimet herëpashershme të ndihmësit personal, është 11,944 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I të vendimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 01.10.2025.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reme Xholi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 5790/prot
2

Tiranë, më 19/08 2025

URDHËR

Nr. 5790/, datë 19-08 2025

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.182, DATË 26.02.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN KRITEREVE, PROCEDURAVE E
DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E PAGESËS PËR
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, SI DHE NDIHMËSIT PERSONAL", TË
NDRYSHUAR**

Bazuar në ligjin nr.57, datë 18.07.2019, "Për Asistencën Sociale në RSH", pikat 1 dhe 6 të kreut II, të VKM nr.182, datë 26.02.2020, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimi të pagesës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ndihmësit personal", të ndryshuar, si dhe VKM nr. 135, datë 07.03.2018 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror", i ndryshuar, për indeksimin vjetor të përfituesve PAK:


URDHËROJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 1, të kreut III, të VKM nr.182, datë 26.02.2020, bëhet 12,993 (dymbëdhjetëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë në muaj.
2. Të njëjtën masë pagese përfiton edhe ndihmësi personal i personit me aftësi të kufizuar, i përcaktuar në shkronjën "b", të nenit 8, të ligjit nr.57/2019.
3. Pagesa e ndihmësit personal të personit me aftësi të kufizuar të përcaktuar në shkronjën "a", të nenit 8 të ligjit 57/2019 bëhet 13,648 (trembëdhjetëmijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë në muaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 01.09.2025.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reme Xholi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 5799/prot
6

Tiranë, më 19.08 2025

URDHËR

Nr. 5799/ datë 19.08 2025

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.277, DATË 18.06.1997, "PËR PËRFITIMET NGA
STATUSI I TË VERBËRIT", I NDRYSHUAR

Bazuar në ligjin nr.57, datë 18.07.2019, "Për Asistencën Sociale në RSH", të pikës 4, të VKM nr.277, datë 18.06.1997, "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", i ndryshuar si dhe VKM nr. 135, datë 07.03.2018 "Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror", i ndryshuar, për indeksimin vjetor të personave që përfitojnë nga statusi i të verbërit:

URDHËROJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277, datë 18.06.1997, i ndryshuar, bëhet 14,748 (katërmëdhjetëmijë e shtatëqind e dyzet e tetë) lekë në muaj.

Të njëjtën masë pagesë përfiton edhe kujdestari i të verbërit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 01.09.2025.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reme Xholi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 5790/prot

Tiranë, më 13/08 2025

URDHËR

Nr. 5790, datë 13.08 2025

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.31, DATË 20.01.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIKË DHE
TETRAPLEGJIKË”, TË NDRYSHUAR**

Bazuar në ligjin nr.57, datë 18.07.2019, “Për Asistencën Sociale në RSH”, ligjin 8626, datë 22.06.2000, “Statusi i Invalidit Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë”, i ndryshuar, të VKM nr.31, datë 20.01.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 135, datë 07.03.2018 “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, i ndryshuar, për indeksimin vjetor të përfituesëve me status invalidi, paraplegjik dhe tetraplegjik:

URDHËROJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të VKM nr.31, datë 20.01.2001, bëhet 12,993 (dymbëdhjetëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë në muaj.
2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të VKM nr.31, datë 20.01.2001, bëhet 13,648 (trembëdhjetëmijë gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë në muaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 01.09.2025.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reme Xholi

